



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 117, Datë 10.06.2024

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “HYDROBORSH” SH.P.K. PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET HIPOTEKIMIT) TË
ASETEVE FIKSE TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 2, gërma “a”, 3, 4, gërmat “a” dhe “b”, 5, gërma “j”, 6, 7, 9 dhe 10 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.06.2016; pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 10.06.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 770/12 prot., datë 07.06.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) e aseteve fikse të saj”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “HYDROBORSH” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Fterra” dhe “Fterra 1”, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 67, datë 06.06.2012.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 770 prot., datë 12.03.2024, ajo ka paraqitur aplikimin për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj, për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse, “BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE” sh.a.
- Për vendimin e bordit të ERE-s nr. 56/2024, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), nëpërmjet shkresës nr. 929 prot., datë 15.04.2024.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 770/5 prot., datë 25.04.2024 dhe nr. 7701/0 prot., datë 30.05.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Me qëllim analizimin e sa depozituar nga shoqëria, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 31.05.2024, është vendosur zgjatja me 30 ditë pune e vendimmarrjes mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj.

- Nga analiza përfundimtare e aplikimit, rezulton se shoqëria “HYDROBORSH” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar nga neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i” dhe “j”; pika 3; pika 4; dhe pika 6 të *Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) e aseteve të paluajtshme të shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve/institucioneve të tjera apo palëve të treta për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe/institucione.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj për të garantuar shlyerjen e detyrimeve ndaj palës kredidhënëse “BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE” sh.a. (sipas listës bashkëlidhur).
2. Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) së aseteve të fikse të shoqërisë “HYDROBORSH” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve/institucioneve të tjera apo palëve të treta për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe/institucione.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “HYDROBORSH” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

INVENTARI I ASETERVE TE PALUAJSHME HYDROBORSH 2024

Palët bien dakort se lista e asetëve të shoqërisë koncesionare “HYDROBORSH shpk” të cilat do të ofrohen kolateral në favor të ABI Bank sha do të jetë ajo e përcaktuar si më poshtë:

- Ndërtesa HEC FTERRE, me vlerë *11,661,932 lekë*.
- Makineri & paisje HEC FTERRA, me vlerë *25,726,931 lekë*.
- Linja 35 KW, me vlerë *28,720,658 lekë*.
- Aktivi ekonomik HEC FTERRA (përfshihen veprat e marrjes VM1 dhe VM2, tubacioni percjelles plastik dhe celik), me vlerë *76,680,859 lekë*.
- Ndërtesa HEC FTERRA I BORSH, me vlerë *24,016,597 lekë*.
- Makineri e paisje HEC FTERRA I BORSH, me vlerë *32,549,869 lekë*.
- Aktivi ekonomik HEC FTERRA I (përfshihen VM3, kanali I derivacionit Fterre Borsh, tuneli, tubacin celiku , sifonat dhe ai i presionit), me vlerë *213, 076,376 lekë*.

Në total rezultojnë 412,433,222 lekë.